



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Teori Letërsie

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare

Viti / Semestri : Viti II , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët me njohuritë kryesore mbi teoritë letrare bashkëkohore. Marrëdhëniet mes autorit, tekstit dhe lexuesit. Vendin e letërsisë në shoqëri dhe marrëdhëniet e saj me të.

Objektivat specifike lëndore:

1. Aftësi për të fituar koncepte bashkëkohore të letërsisë.
2. Njohuri mbi teoritë bazë të letërsisë.
3. Njohuri mbi rrymat letrare.
4. Aftësi për të shprehur mendime të vështira nga ana gjuhësore.
5. Aftësi për të punuar në ekip dhe për të bashkëpunuar me persona të tjerë.
6. Aftësi për të marrë vendime.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë dhe të analizojnë teoritë bashkëkohore letrare, duke kuptuar konceptet thelbësore që lidhen me autorin, tekstin dhe lexuesin.
2. Do të zhvillojnë aftësi kritike për të interpretuar dhe komentuar rrymat letrare dhe ndikimin e tyre në kontekstin kulturor e shoqëror, si dhe për të diskutuar vendin e letërsisë në shoqëri.
3. Do të jenë të aftë të shprehin mendime të argumentuara në mënyrë të qartë dhe të punojnë në mënyrë bashkëpunuese në analiza dhe diskutime letrare, duke marrë vendime në mënyrë të pavarur ose në grup.